



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 15
Rrogozhinë, më 27.12.2024 ora 12 : 00^{oo}

Zhvillohet mbledhja jashtë radhe e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Zëvendëskryetarit së Këshillit Bashkiak me datë 24.12.2024, me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor Bashkia Rrogozhinë”.
- 3- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e Bursave të Nxënësve të Arsimit Parauniversitar”.
- 4- Të ndryshme.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Saimir Cani, Lorena Baku, Altin Tosku, Gezime Met-hasani, Lulzim Hasa, Alime Hoxha, Enver Memolla, Fatmira Thartori, Erind Tosku.

Mungojnë :

Indrit Dedej, Lije Dedej, Besnike Coraj, Merilin Saraçi, Isa Halili, Sokol Gosa, Mitat Daja, Renato Kalemi, Shpati Kolgega, Mukades Gixhari.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.
4. Arben Daja - Përgjegjësi i Arsimit.



5. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
6. Sidorela Aliu - Specialiste e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Erind Tosku – Zëvendëskryetar i Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, gjithsej 11- Këshilltarë.

HAPET MBLEDHJA

Erind Tosku . Të dashur Këshilltarë përpara se ta filloi mbledhjen e këshillit bashkiak na ka ardhur një kërkesë nga këshilltari z. Saimir Cani për mbledhjen e këshillit të sotëm kuorumi është i plotësuar dhe fillojmë me kërkesën që ka ardhur nga z. Saimir Cani anëtar i Këshillit dhe thotë :

Të nderuar Këshilltarë ju bëj me dije që me vullnetin tim të lirë po ju paraqes këtë kërkesë për largimin si anëtar i grupit “Të Bashkuar” të këshilltarëve bashkiak Rrogozhinë. Kjo është kërkesa që na ka ardhur nga Këshilltari Saimir Cani.

Atëherë duke patur kuorumin e plotë për mbledhjen e këshillit e hedhim në miratim rendin e ditës për rendin e ditës? Po, të gjithë pro miratohet.

-Miratohet me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim pika e parë e rendit të ditës.

Erind Tosku . Atëherë pika 2, Miratimi i projektvendimit, “Për miratimin e planit të përmirësimit për arsimin parashkollor Bashkia Rrogozhinë”. Relaton drejtori i Arsimit Orges Tosku.

Orges Tosku . Atëherë përshëndetje të gjithëve Këshilltarë! Ky është një plan që është bërë me asistencë të projektit Bashki të Forta BtF dhe ka për synim që të përmirësojë arsimin parashkollor në të gjithë kopshtet e Bashkisë Rrogozhinë. Duke nisur që nga problematikat për infrastrukturën anën ligjore për mjetet didaktike dhe gjithë problematikat e tjera. Nga analiza që kemi ëbrë për gjithë kopshtet kemi nxjerrë disa problematika që nga infrastruktura që nga ofrimi



i shërbimit të psikologut nëpër kopshte edhe mjetet didaktike. Që këtë vit kemi nisur me marrjen e masave duke nisur që nga parashikimi i buxhetit për mjetet didaktike dhe për infrastrukturë. Për pjesën e shërbimit të psikologut kemi kontaktuar zyrën arsimore që në kopshtet që janë në të njëjtën godinë me shkollën do të ofrohet shërbim nga psikologu. Ky është një plan tre vjeçar që do kohën e vet që të ezaurohen të gjithë problematikat dhe normalisht të përmirësohen nga ana jonë.

Erind Tosku . Ndonjë pyetje?

Enver Memolla . Faleminderit Kryetar, një pyetje për drejtorin vetëm kopshtet apo dhe çerdhet?

Orges Tosku . Vetëm kopshtet.

Erind Tosku . E hedhim në votim Znj. Fatmira? Po, të gjithë pro miratohet.

-Miratohet me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim pika 2 (dy) e rendit të diës.

Vendim nr.70. Miratohet me 11-vota pro, projektvendimi i propozuar nga kryetari bashkisë me shkresën Nr.5268. Prot, datë 24.12.2024 “Për miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor Bashkia Rrogozhinë ”, si dhe Relacionin e këtij projektvendimi me Nr. 5268. Prot datë 19.12.2024.

Erind Tosku . Kalojmë në pikën e 3, miratim i projektvendimit “Për miratimin e bursave të arsimit parauniversitar”. Relaton drejtori i arsimit z. Orges Tosku.

Orges Tosku . Atëherë këto janë bursa që akordohen nga Ministria e Arsimit përpara çdo viti shkollor Ministria e Arsimit harton planin për gjithë shkollat dhe na sjell një kuotë bursash që për Bashkinë Rrogozhinë është 20 bursa. Ne i bëjmë një kërkesë drejtorave të shkollës që sipas kritereve të vendimit 666 të na sjellin emrat e nxënësve. Gjithë drejtorat na sjellin emrat me aftësi të kufizuar me distancë vendbanim shkollë, me ndihmë ekonomike me prindër jetimë dhe është lista e nxënësve gjithmonë që ka ardhur nga drejtorat e shkollës.

Fatmira Thartori . Falenderojmë Ministrinë e Arsimit për bursat që kanë sejlë dhe pikat janë të përcaktuara.

Orges Tosku . Po.



Fatmira Thartori . Apo jo?

Orges Tosku . Kriteret.

Fatmira Thartori . Kriteret që duhet të pranohen për bursat. Mesa shikoj nxënësit e shkollës Gosë ato të paktën që janë me aftësi të kufizuar nuk janë përfshirë që të gjithë. Vetëm një nxënës është me aftësi të kufizuar, do doja që të ishin që të gjithë s'po përmend numrin se sa janë. Jo se këto të tjerët nuk e meritojnë këto që janë shënuar këtu por do doja që të ishin dhe ata tjerët. Vetëm një është përfshirë por janë disa të tjerë pa u përfshirë fare dhe janë si nga ana ekonomike si nga ana sociale janë...

Orges Tosku . Atëherë në momentin që Ministria e Arsimit akordon numrin e bursave ne lajmërojmë gjithë drejtorat nëpër shkolla që sipas vendimit nr.666, që janë dhe kriteret me aftësi të kufizuar, ndihmë ekonomike, arrijtjet sjellin emrat. Drejtoresha apo drejtori që është tek filan shkollë që thua ti këto emra nuk i ka sjellë fare nuk është që i ka sjellë dhe nuk i kemi futur ne ka futur vetëm një, janë hequr pesë është futur një.

Hekuran Xhani . Tani në mbështetje të diskutimit të koleges Ministria ka sjellë një kuotë edhe është kaq, apo ka thënë që të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuar dhe fëmijët e prindërve me ndihmë sociale përfitojnë.

Orges Tosku . Atëherë Ministria sjell kuotat.

Hekuran Xhani . Pra atëherë ju duhet të bëni në rast se ju vijnë 20 kërkesa ju jeni të detyruar të çoni vetëm 20 apo sipas realitetit që ndodhet nëpër shkolla.

Orges Tosku . Ne normalisht duhet të çojmë 20 ndërkohë numri është 32, numri i kuotave që ka sjellë Ministria e Arsimit është 20, ne diskutuam me drejtorin e financës 20 do marrin nga ministria e arsimit pjesa tjetër do mbulohet nga buxheti i bashkisë.

Hekuran Xhani . Atëherë ne na lind e drejta në rast se do të shtojmë atëherë këto 20 kuota nga Ministria e Arsimit janë plotësuar edhe për shkak faj çfarë t'i themi ne tani apo pakujdesi të drejtorave nuk kanë ardhur. Në rast se ekziston mundësia meqë kjo do jetë fondi i Bashkisë, në bashkëpunim me zyrën e financave të shtojmë, pastaj këto që janë në nevojë me fondet e bashkisë por gjithmonë duke u konsultuar me zyrën e financave.

Orges Tosku . Këto kanë një afat është muaji Dhjetor.



Hekuran Xhani . Ne do të votojmë sot ty kuotat që kërkon Ministria e Arsimit se ajo digjet, kjo nuk të digjet ty në bashki. Jam gabim shef?

Enver Memolla . Unë do ta nis pak nga A-ja, jo nga Zh-ja që është kjo. Ju thoni që afati përfundimtar për dorëzimin e listës është Dhjetori?

Orges Tosku . Për miratimin në Këshill.

Hekuran Xhani . Kuotën që ka sjellë Ministria.

Enver Memolla . Ju po thoni me anë të sjelljes së Urdhërit të ministrisë keni vënë në dijeni drejtorat e shkollave. Pse nuk kam funksionuar me Institucionet e ZVA-së dhe Bashkisë Rrogozhinë rakordimi për këtë pjesë? Dhe ku të vihet në dijeni ZVA-ja Rrogozhinë jo se është Alimeja këtu, që po nga ministria kemi 20 nga ju sa do vijë totali dhe sa që ta kishim diskutuar në buxhet fondin e këtyre për të rritur fondin tuaj të ministrisë së arsimit buxhetin e ardhshëm që të gjithë nxënësit siç thotë që janë 4-5 ta mërrnin këtë bursë sepse nuk mund të bëjmë selektiv.

Orges Tosku . O Ver nuk ka ardhur fare si emër më vjen keq tani.

Enver Memolla . Unë këtë po flas keni të drejtë ligjore të ja çoni ju drejtorave apo të vini në dijeni zyrën arsimore.

Orges Tosku . Atëherë ne kemi një grup në ehatsapp që bashkëpunojmë...

Enver Memolla . Iku kjo në ehatsapp unë po flas për shkresa.

Enver Memolla . Edhe ai lajmërim është se dhe ti kur lajmërohesh për këshill online lajmërohesh.

Hekuran Xhani . Tani o Veri problemi qëndron këtu, ne sot miratojmë listën kuotën që ka sjellë Ministria për vitin 2024, një. Dy ne e lamë dhe për disa rishikime tek paketa fiskale mund të bëjmë dhe ndryshime të buxhetit e lam në Janar dhe për disa taksa që ne propozuam këtu tek buxheti kur të bëjmë ndryshime i shtojmë në bashkëpunim edhe njëherë me shefin e financave edhe fusim dhe këto familje që janë shumë në nevojë.

Enver Memolla . Propozimi im është ky që bëjmë, të kalojmë projektvendimin sot me emrat që janë dhe në mbledhjen e ardhshme të fusim emra të tjerë që në Mars të bëhet ndryshimi...



Silvana Aliu . Se dhe këto emra nuk është e drejtë që të futësh ti tre fëmijë nga një familje dhe të heqësh tjerët.

Orges Tosku . Kujt i është faji?

Silvana Aliu . I drejtoreshës pra.

Orges Tosku . Po në rregull pra.

Alime Hoxha . Një minutë faji mund të jetë i drejtoreshës, duhet të keni dhe ju një kriter për t'i rregulluar se drejtoresha mund të sjellë dhe 20 emra.

Orges Tosku . Mund të jenë 50 nxënës me aftësi, drejtoresha i ka të gjithë të evidentuar. Punën e drejtoreshës unë do e bëj atje? Drejtoresha kur ka sjellë këtë emrin të sillte dhe ato 5 emra.

Alime Hoxha . Të ka sjellë dokumentacion shoqërues për secilin?

Orges Tosku . Po.

Alime Hoxha . Nuk i paske parë që janë nga e njëjta familje? Flasim për ato tre emrat që thotë ajo.

Orges Tosku . Po pra por e meritojnë kanë plotësuar kriterin .

Alime Hoxha . E përfitojnë të tre?

Arben Daja . Po sepse ato vijnë nga zonat që janë larg që nuk kanë shkolla.

Silvana Aliu . Dhe ato me AK...?

Orges Tosku . Nuk i ka sjellë jo që nuk e meritojnë.

Arben Daja . I kemi futur ato që na i kanë sjellë.

Alime Hoxha . Nuk i ka sjellë drejtori thotë.

Arben Daja . Unë nuk i njoh kush janë ato në shkollë.



Orges Tosku . Unë nuk e di se unë i çoj shkresën drejtorit...

Fatmira Thartori . Unë jam dakord me listën por puna është se duhen shtuar të tjerë.

Orges Tosku . Këtë duhet të ja kërkosh drejtorit. Drejtori kur është lajmëruar është lajmëruar sill sipas kriterëve dhe vendimin e ka lexuar edhe drejtori, ai ka sjell një ne kemi sjell një nuk është se ka sjell pesë dhe ne sollëm një.

Alime Hoxha . Bëhen ndryshime apo nuk bëhen ndryshime?

Orges Tosku . Ndryshime tek kjo nuk bëhen. Në qoftë se pastaj do bëhet me fondet e bashkisë duhet parë. Kurse këtu më bërë kot të bukrin dhe të mirin nuk shkon.

Hekuran Xhani . Këtu duhet një bashkëpunim ndërinstitucional zyra e arsimit të bashkisë...

Orges Tosku . Kur erdhi drejtoresha dje pse nuk solli pesë?

Hekuran Xhani . Kjo listë duhet të kishte marrë ok-ein edhe të bashkisë por edhe nën mbikqyrjen e shefes së zyrës së arsimit që të shihej pse tre vetë në një familje.

Orges Tosku . Ato profesionalet u dogjën katër, kurse këto kanë nuk i sjellin është problem që nuk na takon ne.

Erind Tosku . O Silvana ne nuk zgjidhim gjë në këtë formë, çështja është në qoftë se ka mundësi të shtohet në mbledhjen e radhës numri i këtyre nxënësve që nuk kanë sjellë dokumentacionin por buxheti i 2025 na lejon për të shtuar dhe 4 ose 5 në qoftë se bëhet bëhet dhe ta kalojmë miratimin e kësaj.

Lulzim Hasa . Erind merre hidhe në votim se unë do iki do ta lë kështu pastaj.

Enver Memolla . Kjo duhet miratuar dhe listë tjetër që do vijë me fondet e bashkisë nëse bashka ka fond ta miratojë që paguan bashkia.

Orges Tosku . Ne nuk jemi kundër.

Enver Memolla . Unë këtë thashë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

Hekuran Xhani . Bashkia, shefi i financës duhet të shte sot këtu se nesër nuk ta miraton ai.

Lulzim Hasa . Po mirë pse duhet t'i djegim këto 20 ne? Tjetra ti Fatmira e verifikove atë shkollë po 7 shkollat tjera kush do i verifikojë? Hajde miratojmë këto 20 emrat shtesë me një vendim tjetër, i miratojmë.

Hekuran Xhani . Lulo a kam ngrëjtur dorën e kam votuar, hajde.

Fatmira Thartori . Mos e hidh në votim do e digjni unë nuk e votoj

Erind Tosku . Unë e hedh në votim, o zonja Fatmira mos e voto në qoftë se ashtu ta hedhim në votim se të gjithë kemi angazhime. Ne e diskutuam këtë pjesën.

Fatmira Thartori . Prit njëherë më the në qoftë se ka fonde dhe nesër pasnesër...

Orges Tosku . Këtë nuk e them dot unë duhet me folur me drejtorin.

Fatmira Thartori . Të ishte drejtori i financës këtu.

Erind Tosku . është replikë e kotë kjo pjesë e hedhim në votim pikën 3, “Për miratimin e Bursave të Nxënësve të Arsimit Parauniversitar”. E hedhim në votim. 10 janë pro, një nuk voton nuk miratohet.

Mirupafshim mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 12 : 20^{oo} . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 16 min ; 16 sek.
- Ky procesverbal mbyllet në faqen 8 (tetë).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

Sekretari i Këshillit

Ervis Shera